



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI KOMISIONERI

Nr. 1363/3 Prot.

Tiranë, më 13.08.2026

V E N D I M

Nr. 220, Datë 13._08.2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32 dhe neni 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 172 Regj., datë 16.07.2026, të z. S. I., përfaqësuar nga Av. S. I., sipas Prokurës së Posaçme nr. 5849 rep., nr. 3245 kol., datë 06.12.2024, kundër Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit ankuesi ka parashtruar si vijon: *Ankuesi S. I., pretendon se, në cilësinë e punëmarrësit, ka qenë i punësuar pranë Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a që nga data 07.06.2011, fillimisht në pozicionin “Specialist i Pasurisë së Patundshme DT” dhe, në vijim, në pozicionin “Analist i Dhënave”, marrëdhënie pune e cila ka vijuar deri më datë 04.03.2025, datë në të cilën i është njoftuar ndërprerja e njëanshme e marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare nga ana e punëdhënësit. Ankuesi pretendon se, me shkresën nr. 11038/1 prot., datë 24.10.2024, me lëndë “Masë disiplinore”, i është komunikuar vendimi për caktimin e masës disiplinore “Kalim në një detyrë me pagë më të ulët”, të motivuar me moskryerjen e detyrës funksionale dhe performancë të dobët, pa asnjë renditje apo motivacion konkret që të justifikonte këtë veprim.*

Sipas ankuesit, në muajin tetor 2024 punëdhënësi ka nisur me insistim manovra për largimin e tij nga puna, pa asnjë shkak të justifikuar apo bazuar në prova konkrete, deri sa marrëdhënia e punës i është zgjidhur në mënyrë të menjëhershme, pa masë paralajmëruese apo njoftim paraprak, dhe pa u marrë parasysh se ai ndodhej në trajtim mjekësor për shkak të një dëmtimi në këmbë. Ankuesi pretendon se ka shprehur haptazi bindjet e tij politike të djathta, çka sipas tij ka qenë shkak i trajtimit të tij në mënyrë të ndryshme e të diferencuar, duke ia atribuar fillimisht masën disiplinore të datës 24.10.2024 dhe, më pas, largimin përfundimisht nga puna, moment i cili sipas tij përkon me periudhën përpara zgjedhjeve politike të muajit maj 2025. Ankuesi pretendon gjithashtu se largimi nga puna i ka shkaktuar një dëm në shëndetin e tij, të vërtetuar me përgjigje-rekomandim të një specialisti neuropsikiatër.

Masat që kërkohen nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

1. Pranimin e ankesës.
2. Konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike, nga Shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a ndaj ankuesit S. I.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës nr. 172 Regj., datë 16.07.2026, paraqitur kundër Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”, u vlerësua e nevojshme administrimi i informacionit dhe dokumentacionit shtesë për sqarimin e plotë të rrethanave të çështjes.

Në këtë kuadër, me shkresën nr. 1363/2 prot., datë 17.07.2026, Komisioneri iu drejtua përfaqësuesit ligjor të ankuesit, Av. S. L., duke i kërkuar të depozitojë: dokumentacion, fakte apo prova që tregojnë se ankuesi S. I., ka bindje politike të djathta, duke shpjeguar konkretisht mbi çfarë bazohet ky pretendim dhe kur i ka shprehur apo demonstruar këto bindje; shpjegime, informacion, fakte apo prova mbi bazën e të cilave pretendohet se Shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a ka pasur dijeni për bindjet politike të djathta të ankuesit; nëse ankuesi i ka ekspozuar publikisht bindjet e tij politike, në çfarëdolloj mënyre apo mjeti (rrjete sociale, veprimtari politike, deklaratat publike etj.); informacion nëse janë në dijeni për raste të tjera punonjësish në pozicione të ngjashme, të trajtuar në mënyrë të ndryshme nga i njëjti punëdhënës; si dhe çdo informacion apo dokumentacion tjetër shtesë në mbështetje të ankesës. Afati i përcaktuar për depozitimin e këtij informacioni ishte 10 (dhjetë) ditë nga data e komunikimit të shkresës.

Në lidhje me kërkesat e përcaktuara në shkresën e sipërcituar, brenda afatit të përcaktuar, ankuesi, nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, nuk depozitoi pranë Komisionerit asnjë informacion apo dokumentacion shtesë, megjithëse shkresa i ishte komunikuar rregullisht.

Në nenin 1, të LMD (Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar) përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të LMD, diskriminimi përcaktohet si: “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, përcaktohet se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të

njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Bazuar në nenin 12, pika 1, të LMD, përcaktohet se: *“Ndalohe diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”*

Bazuar në nenin 33, pika 1, të LMD, përcaktohet se: *“1. Një person ose grup personash që pretendon se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal.”*

Bazuar në nenin 32, pika 3, të LMD, përcaktohet se: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”*

Bazuar në nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;”*

Bazuar në nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”*

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës dhe mbështetur në faktet dhe pretendimet e parashtruara nga ankuesi, Komisioneri vlerëson se, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “ç” të LMD, ku përcaktohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.”*, ankesa objekt shqyrtimi nuk duhet të pranohet pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm, për arsyet e mëposhtme:

Ankuesi S. I., pretendon se Shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a e ka trajtuar në mënyrë diskriminuese, për shkak të bindjeve të tij politike të djathta, nëpërmjet caktimit të një mase disiplinore me shkresën nr. 11038/1 prot., datë 24.10.2024, dhe, në vijim, zgjidhjes së njëanshme e të menjëhershme të kontratës së punës me shkresën nr. 12943/4 prot., datë 04.03.2025. Ankuesi mbështetet vetëm në faktin se largimi i tij përkon në kohë me periudhën përpara zgjedhjeve politike të muajit maj 2025, si dhe në Vendimin nr. 1350, datë 18.03.2026 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, i cili ka konstatuar mungesën e shkaqeve të justifikuara për zgjidhjen e kontratës së punës, por vetëm nën këndvështrimin e legjislacionit të punës, pa u shprehur dhe pa pasur për objekt ekzistencën e ndonjë trajtimi diskriminues për shkak të bindjeve politike.

Me shkresën nr. 1363/2 prot., datë 17.07.2026, Komisioneri iu drejtua përfaqësuesit ligjor të ankuesit, duke kërkuar depozitim të dokumentacionit, fakteve apo provave konkrete mbi ekzistencën e bindjeve politike të djathta të ankuesit, dijenin e punëdhënësit për to, ekspozimin e tyre publik, si dhe raste krahasimi me punonjës të tjerë të trajtuar ndryshe. Brenda afatit 10-ditor të përcaktuar, si dhe deri në datën e marrjes së këtij vendimi, ankuesi nuk depozitoi asnjë

përgjigje, informacion apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimit për diskriminim.

Për rrjedhojë, as ankesa dhe as dokumentacioni i administruar nuk përmbajnë asnjë element apo provë konkrete që të vërtetojnë ekzistencën e bindjeve politike të djathta të ankuesit, dijenin e punëdhënësit mbi to, lidhjen shkakësore mes tyre dhe masës disiplinore apo zgjidhjes së kontratës, apo raste krahasimi me punonjës të tjerë të trajtuar në mënyrë më favorshme. Afërsia kohore e pretenduar mes largimit nga puna dhe zgjedhjeve politike, në mungesë të çdo elementi tjetër provues, nuk përbën, në vetvete, indicie të mjaftueshme për të themeluar një pretendim për diskriminim për shkak të bindjeve politike.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “ç”, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa nr. 172 Regj., datë 16.07.2026, e paraqitur nga pala ankuese S. I., kundër Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a, nuk duhet të pranohet për t’iu nënshtruar procedurave të mëtejshme për shqyrtimin e saj, pasi, **nuk** ka informacion dhe të dhëna të mjaftueshme që të bëjnë të mundur zhvillimin e një hetimi administrativ për verifikimin e pretendimeve të parashtruara në ankesë. Për rrjedhojë, ankesa nuk plotëson kushtet për vijimin e procedurave të mëtejshme të shqyrtimit nga Komisioneri.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32 dhe nenin 33 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës me nr. 172 Regj., datë 16.07.2026, të z. S. I., kundër Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”, pa një vendim përfundimtar për çështjen, për arsye se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)